

Data . . . 2022

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i prokurimit: “Rikonstruksion i Rrugës Sheq-Gajdë”

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV): 45112000-5 , 45233160-8 ,
45233222-1

Vlera e fondit limit: 60 391 938 Lek pa TVSH

Argumentimi : Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës është referuar në preventivin e përlllogaritur mbështetur në VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.

Në bazë të Nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Nenit 2, pika 2/c si dhe Nenit 78, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Autoriteti Kontraktor, Bashkia Dimal , ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

(të plotësohet nga autoriteti përgjegjës)

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, sipas shtojcës 10.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" si dhe nenit

Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Kopje të deklarimit të xhiros mesatare vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit (2019, 2020, 2021) e cila duhet të ketë një vlerë mesatare, jo me te ulet se 40% të vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet, lëshuar nga administrata tatimore.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe në Kreun V, Seksioni III, Nenin 43, pika 2 dhe pika 3 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Kërkesat e renditura sipas Kapacitetit ekonomik dhe financiar (pika 1 dhe pika 2) i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për të provuar nëse Ofertuesit zotërojnë kapacitet financiar për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi.

2. Kopje të vërtetuara të bilanceve të konfirmuara pranë autoriteteve përkatëse (administrata tatimore) të tre viteve të fundit (2019, 2020, 2021) (ne rastet e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter duhet të plotësohet nga cdo anëtar i bashkimit).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik"; si dhe Kreun V, Seksioni III, Nenin 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit Nr. 10091 datë 5.3.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" (i ndryshuar).

3. Dokument që vërteton se ka shlyer detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për vitin 2021 dhe 2022, prane të gjitha njësive vendore ku operatori ekonomik ka ushtruar apo ushtron aktivitetin sipas ekstraktit të QKR. (Ne rastet e bashkimit të operatoreve ekonomike, ky vërtetim duhet të paraqitet nga secili prej pjesëtareve të bashkimit)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik"; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" si dhe sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" (i ndryshuar). Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, Bashkia Dimal, është njësi e vetëqeverisjes vendore, e cila funksionon dhe ka kompetenca të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Njësia e Prokurimit argumenton se pika 3 është vendosur në kuadër të

Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar), Neni 5, gërma “c” ku citohet se: “...përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale”.

4. Vërtetim nga Bashkia Dimal– Autoriteti Kontraktor, se ofertuesi nuk ka detyrime ndaj Autoritetit Tonë, të lëshuar jo më vonë se 5 ditë përpara datës së hapjes së ofertes. Do të konsiderohen detyrime të gjitha shumat që janë rrjedhojë e një detyrimi financiar të çfarëdolloj natyre.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe sipas Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar). Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, Bashkia Dimal, është njësi e vetëqeverisjes vendore, e cila funksionon dhe ka kompetenca të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Njësia e Prokurimit argumenton se pika 4 është vendosur që Autoriteti Kontraktor të krijojë bindje për mospasjen e detyrimeve tatimore për subjektet në një periudhë kohore sa më të afërt, me kohën e kryerjes së prokurimit, dhe kjo i shërben Autoritetit Kontraktor, për të provuar nëse Ofertuesit zotërojnë kapacitet financiar për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi.

3 Kapaciteti teknik:

Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

- a) Punë të ngjashme e realizuar në një kontratë të vetme në një vlerë jo më e vogël se 40 % e fondit limit, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së kontratës, ku zërat e punimeve respektive plotësojnë kriteret minimale të preventivit të objektit të prokurimit.
Ose
- b) Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e kontratave të punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë sa vlera e fondit limit.

Plotësimi i njerit prej dy kushteve të sipërpermendura e bënë oferten të kualifikueshme.

3.1/a Për kontratë të realizuara me autoritete publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Formularin e vlerësimit;
2. Kontratën/Kontratën;
3. Situacionin përfundimtar;
4. Aktin e kolaudimit;
5. Çertifikatën/certifikatat e marrjes në dorezim;
6. Faturat tatimore;

3.1/b Për kontratë të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Kontratë;
2. Lejen e ndertimit;
3. Situacionin përfundimtar;

4. Aktkollaudimiobjekti;
5. Çertifikatëpërdorimi
6. Faturatatimore

Pika 3.a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes të tyre në bashkim.

Kurse pika 3.b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes të tyre në bashkim.

Argumentimi: Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj u hartua duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që Operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që:

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet, dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose,
- b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin kur Operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

Gjithashtu referuar VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, Kreu XI, Neni 88, pika 3 citohet se: “Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.” AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave (1.2-1.4), të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

4. Operatori Ekonomik ofertues për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të zotërojë Liçencën Profesionale të lëshuar nga institucionet e autorizuar me ligj në kategoritë si më poshtë:

PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

NP-1-C

Punime gërmimi në tokë

NP-4 -C Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaj, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale.

NP - 5 – A PunimentoksoreUra e VepraArti

NP – 9 –A Punime mbrojtje lumore, sistemime hidraulike dhe bonifikime.

NP -12 – B Punime të inxhinierisë së mjedisit.

PUNIME SPECIALE NDËRTIMI

NS - 6 - A Sinjalistika rrugore jo ndriçuese

NS - 7 - A Barriera dhe mbrojtje rrugore

NS - 9 - B Punime strukturore special

NS - 10 - A Shtresa dhe mbistruktura speciale

NS-18-A Punime topogjeodezike

Per operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licenses profesionale që disponojnë nga vendi i origjines nga institucioni i autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për dhenien e licencave profesionale në fushën e studimit e projektimit në ndërtim, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, pika 1 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6/a, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Referuar kategorive të kërkuara, AK argumenton teknikisht se kjo kërkesë është vendosur sipas zërave të preventivit të punimeve.

Për sa më lart, me qëllim realizimin e punës objekt prokurimi, është kërkuar që Ofertuesit të jenë të pajisur me Licencë profesionale për kategoritë, të cilat janë vendosur sipas volumeve të punimeve dhe vlerave që përmban Preventivi për çdo zë pune mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, ku janë përcaktuar kategoritë dhe nënkategoritë përkatëse. Kjo kërkesë është vendosur nga Autoriteti Kontraktor me qëllim shqyrtimin e kualifikimit profesional të Ofertuesve në kuadër të veprimtarisë tregtare objekt prokurimi.

NP-1-C (Punime gjërmimi në tokë)

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me gjërmime në tokë, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

NP-4 –C (Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaji, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale)

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me punime në rrugë, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me

NP - 5 – A Punime nëntokësore, ura e vepra arti

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me punime që lidhen me punime nëntokësore, ura, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

NP – 9 –A Punime mbrojtje lumore, sistemime hidraulike dhe bonifikime.

Duke qene se në projekt e preventiv janë parashikuar punime të natyrës punime hidraulike, bonifikim është e nevojshme zotërimi i kësaj pike license

NP -12 – B Punime të inxhinierisë së mjedisit.

Duke qene se në projekt e preventiv janë parashikuar punime të natyrës punime të inxhinierisë së mjedisit është e nevojshme zotërimi i kësaj pike license.

PUNIME SPECIALE NDËRTIMI

NS - 6 - A Sinjalistika rrugore jo ndriçuese

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me punime që lidhen me punime të sinjalistikës rrugore e jondriçuese ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

NS - 7 - A Barriera dhe mbrojtje rrugore

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me punime që lidhen me punime të mbrojtjes rrugore dhe barrierave, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

NS - 9 - B Punime strukturore special

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me punime punime strikturore special, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

NS - 10 - A Shtresa dhe mbistruktura speciale

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me punime mbistruktura specialise, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me punime topogjeodezike, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

Klasifikimi i shoqërive ndërtimore sipas niveleve për çdo kategori punimesh zbatimi i referohet Vendimit të Keshillit të Ministrave Nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

5. Operatori Ekonomik ofertues duhet që të ketë në stafin e tij minimalisht 1(një) Inxhinier (Drejtues Teknik në licencë) i cili të jetë i Çertifikuar për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë. Për këtë operatori ekonomik duhet të dorëzojë:
 - ❖ Certifikatën për Inxhinierin
 - ❖ Diplome
 - ❖ Kontrate pune notoriale
 - ❖ Librezen e punës
 - ❖ CV përkatës
 - Në rast të bashkimit të Operatoreve Ekonomik (JV) çdo anëtar i bashkimit duhet të plotësojë kriterin e mesiperm.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Kërkesa e mësipërme mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” si dhe ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”. Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmën e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

- 5.1 Kandidati ofertues duhet të deklarojë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt të përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, gjithashtu të gjithë drejtuesit teknik të shoqërisë të jenë të deklaruar në listë pagesat e shoqërisë sipas formularit të deklarimit.

Kjo e provuar me dokumentacionin i mëposhtem:

- CV perkatese
- Kontratepunenoteriale
- Diplome
- Librezepune

Ne rast te bashkimit te Operatoreve Ekonomik (JV) çdo anetar i bashkimit duhet te plotesoje kriterin e mesiperm.

Argumentimi:

6. Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet te kene nje punësim mesatar jo me pak se 30 (tridhjetë) punonjesish, për periudhën **Janar 2022 – Korrik 2022**të vërtetuar me;
 - a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën **Janar 2022 – Korrik 2022**.
 - b) Listëpagesat e punonjesve sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi te konfirmuara nga administrata tatimore per periudhen **Janar 2022 – Korrik 2022**, te shoqëruar me formularet e deklarimit te pagesave për sigurimet shoqërore dhe shendetesore. Për këtë operatori duhet të paraqesë formularin E-SIG 025 për periudhën e kërkuar.
- **Argumentimi:** Autoriteti Kontraktor këtë kriter e ka bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” në të cilin thuhet: “Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.
- Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në afatin, orët e punës dhe pagën minimale të lejuar, që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje **Janar 2022- Korrik 2022**, tregon besueshmëri për autoritetin. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument qe vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim **te paktën 30 (tridhjetë)** personave duke përfshire dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet. Po t’i referohemi projektit, preventivit, relacionit, matjeve përkatëse që ka bërë projektuesi është plotësisht i justifikuar numri i punonjësve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t’i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë,

kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

- *Analizat teknike janë bazuar në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018). Bazuar në kriter elementet e strukturës së kostos (material, puntori, makineri, transport) zëri fuqi punëtorë të rreth 20% të kostos.*

7. Operatori ekonomik duhet të ketë drejtues teknikë në licence dhe të figurojnë në listepagesa të punësuar në shoqëri :

- Inxhinier Ndërtimi (2)
- Inxhinier Topograf, Gjeodet (2)
- Inxhinier Mjedisi (1)
- Inxhinier Mekanik (1)
- Inxhinier Hidroteknik (1)
- Inxhinier Gjeolog (1)

Sa me sipër operatori ekonomik duhet të paraqesë, kontratë punë, diplomë, CV dhe të jete në listepagese.

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pikë 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pikë 6, gërma “c”.

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar sipas pikës 5, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtorë të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi. Në preventivin e Punimeve ka zëra punë si: Gërmim dheu, Gërmim dheu për shtyllat dhe pusetat + transp... ; si dhe zëra të tjerë të cilët shtrajnë domosdoshmërinë dhe nevojën për prezencën e inxhinierëve të kërkuar.

8. Gjithashtu operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e shoqërisë të punësuar dhe në Listepagesa:

- Mjek 1 (një) të pajisur me licencë, kjo të shoqërohet me Kontratë punë Nateriale dhe Leje Individuale për Ushtrimin e Profesioneve të Mjekut , CV dhe të jete në listepagese.
- Punonjes të Ndiqjes së Shpejte 3 (tre) për të cilët duhet të paraqesë certifikatën e trajnimit të vlefshme, dhe të jete në listepagese, ku 1 (një) nga punonjësit duhet të jete Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave.

- Minimalisht 3 (tre) Specialist Ndertimi shoqeruar me certifikate trajnimi dhe kontrate pune dhe te jete ne listepagese.
- Minimalisht 1 (nje) Teknik Topograf shoqeruar me certifikate trajnimi dhe kontrate pune dhe te jete ne listepagese.
- Minimalisht 1(nje)Teknik ndertimi shoqeruar me diplome ose License te jete me kontrat pune dhe ne listpagese
- Manovratore 5 (pese), te pajisur me Deshmi e aftesise profesionale per perdoruesit e makinerive te renda te ndertimit dhe punimeve ne toke te shoqeruar me kontratat e punes dhe te jene ne listepagese.
- Shofer me CAP 3 (Tre), kontrate pune dhe te jene ne listepagese.
- Minimalisht 15(pesembedhjetë) punonjes te pajisur me deshmi nga IQT ose Ekuivalente me te, te cilet te figurojne ne listepagesa. Nga te cilet te jene te pajisur me deshmi nga IQT, te kene kontrate pune dhe te figurojne ne listemapagese :

1 (një) Inxhinier Ndertimi, 1 (nje) Inxhinierë Mekanik, 2 (dy) Teknikë Ndërtimi, 2 (dy) Hidraulikë, 1 (një) Saldator, 2 (dy) Mekanik, 1 (nje) Elektracist, 2 (dy) Karpentier, 1 (nje) Murator, 1 (nje) Hekurkthyes.

Argumentimi: Këto kërkesa janë bazuar ne legjislacione sipas fushës së veprimit.

Është bazuar në përputhje me parashikimet e VKM nr. 108, datë 9.2.2011 “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë” i ndryshuar, sipas të cilave, kompanitë që operojnë në fushën e ndërtimit, mund të sigurojnë shërbimet mjekesore për stafin e tyre, nëpërmjetë punesimit të një mjeku, apo nëpërmjet marrëdhënieve kontraktore me individe apo subjekte që operojnë që në këtë fushë.

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Kërkesa e mësipërme mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier" si dhe ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”. Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmën e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

Operatori/ët ekonomik/ë, që gjatë kryerjes së ushtrimit të veprimtarisë, duhet të ketë/në kualifikimet dhe dokumentat përkatëse lidhur me ndikimin në mjedis dhe rehabilitimit të mjedisit, për raste ndotjesh siç parashikon VKM-ja nr.312/2010. Rregullat dhe procedurat e përgjithshme për garantimin e mbrojtjes në një nivel të lartë të mjedisit janë detyrim ligjor për çdo subjekt tregtar person fizik apo juridik për parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga çdo rrezik dhe të papritur në punë

dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës.

Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Njësia e Prokurimit duke marrë në konsideratë natyrën e punimeve; makineritë që do të kërkohen për realizimin e punimeve (Shtojca 8) si dhe Preventivin e Punimeve shtron nevojën që Ofertuesit të kenë të punësuar

Kërkesa specifike për Stafin teknik është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2.3.2 (kapaciteti teknik në DST) si dhe në përputhje me Stafin inxhinierik të kërkuar sipas pikës 2.3.5, (kapaciteti teknik në DST). Stafi teknik (në bashkëpunim me stafin inxhinierik, si dhe fuqinë tjetër punëtore) do jetë përgjegjës për të ekzekutuar kontratën objekt prokurimi në zbatim të plotë me Projektin e zbatimit si dhe brenda afatit të parashikuar në Njoftimin e Kontratës.

Për sa më lart, gjykohet e arsyeshme që Ofertuesit duhet të kenë staf teknik, i cili do të garantojë zbatimin e punimeve sipas Specifikimeve teknike dhe do jetë përgjegjës për realizimin e zërave të Preventivit.

Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me diplomë/deshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, Kërkesa për stafin teknik është mbështetur gjithashtu në “Rregulloren e sigurimit dhe shfrytëzimit teknik për impiantet, pajisjet dhe instalimet elektrike” ku janë përcaktuar edhe kategoritë e dëshmive të kualifikimit të sigurimit teknik.

9. Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të deshmojnë se disponojnë mjetet për realizimin me sukses të objektit të prokurimit, për këtë duhet të paraqesin:

Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës.

Mjetet	Sasia	Gjendja
Kamiona vetshkarkues mbi 16 ton	4 cope	Pronësi ose me qera
Kamiona vetshkarkues 7.5-16 ton	2 cope	Pronësi ose me qera
Kamionçina	3 cope	Pronësi ose me qera
Eskavator me zinxhir	3 cope	Pronësi ose me qera
Eskavator me goma	1 cope	Pronësi ose me qera
Betoniëre Kantieri	5 cope	Pronësi ose me qera
Fadrome (Skrep) me goma	1 cope	Pronësi ose me qera
Motosaldatrice	2 cope	Pronësi ose me qera
Autobetoniëre	2 cope	Pronësi ose me qera
Autopomp për hedhjebetoni	1 cope	Pronësi ose me qera

Gjeneratore	2 cope	Pronësi ose me qera
Minieskavator	4 cope	Pronësi ose me qera
Asfaltoshtruese	1 cope	Pronësi ose me qera
Rrulangjeshës	3 cope	Pronësi ose me qera
Rrulasfalti	1 cope	Pronësi ose me qera
Grejder	1 cope	Pronësi ose me qera
Aparat Topogjeodezik GPS	1 cope	Pronësi ose me qera
Tabela (kantieri)	15 cope	Pronësi ose me qera
Kaska – kokore	30 cope	Pronësi ose me qera
Vibrator	2 cope	Pronësi ose me qera
Tokmak elektrik	1 cope	Pronësi ose me qera
Matrapik	2 cope	Pronësi ose me qera
Fikse Zjarri	5 cope	Pronësi ose me qera
Kuti ndihme e shpejte	5 cope	Pronësi ose me qera
Karro dore	15 cope	Pronësi ose me qera
Depozita uji	6 cope	Pronësi ose me qera
Kontenier Stacioner (zyre ne objekt)	1 cope	Pronësi ose me qera
Autobitumatrice	1 cope	Pronësi ose me qera
Bot Uji	1 cope	Pronësi ose me qira

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (te vlefshme) dhe certifikaten e transportit të leshuar nga bashkia perkatese. Për mjetet e siguruar me qera, të vertetohet me kontratën e qerave të noterizuar, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.
- Në rastin e mjeteve të tjera duhet të paraqiten aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore të blerjes, të përkthyer dhe noterizuar në gjuhën shqipe.
- Operatori ekonomik ofertues duhet të deklarojë se mjetet e paraqitura në oferte nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe do të jenë në dispozicion të zbatimit të punimeve në objektin që tenderohet, Gjithashtu duhet të deklarojë vendodhjen e tyre me qëllim verifikimi.
- Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të vetdeklaruar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës bazuar në VKM nr. 629, datë 15.7.2015, “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018), specifikimet teknike të projektit, volumet e miratuara nga projektuesi.

Shënim: Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit deshmues për kërkesat që përshihen në formularin përmbledhës të vetedeklarimit, mbajme në konsideratë

percaktimet e nenit 26, pika 6, te VKM 285, DT.19.05.2021, i ndryshuar , ku parashikohet qe “Perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kerkon ofertuesit te kualifikuar i pari dorezimin e dokumenteve provuese te parashikuara ne shkronjar “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j”, te pikes 2 te ketij neni , si dhe dokumentet e tjera shoqeruese te ofertes, te dorezuara ne rruge elektronike. Keto dokumente duhet te paraqiten ne original ose ne kopje te njehsuara me origjinalin.

10. Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet te disponojne:

Impiant prodhim Betoni me QKL	1 cope	Pronësi ose me qira
Impiant prodhim Inertesh per betonin me QKL	1 cope	Pronësi ose me qira
Linje per thyerje Guri me QKL	1 cope	Pronësi ose me qira
Impiant per prodhimin e asfaltit	1 cope	Pronesi ose me qira

Per sa mesiper duhet te paraqesin dokumentacionin e pronesise apo marrjes me qera, te shoqeruar me leje mjedisore te leshuar nga QKL si meposhte :

-QKL – Leje Mjedisore te tipit B, Kodi: III.1.B “Per impiant betoni, prodhimin e produkteve te betonit, shoqeruar me planvendosjen per Impiantin, monitorimin mjedisor.

-QKL – Leje Mjedisore Kodi: III.1.B. “Per Impiant Inertesh”

-QKL – Leje Mjedisore Kodi: III.1.B. “Nxjerrja e mineraleve, rërës dhe argjilës nga minierat me shfrytëzim në qiell të hapur dhe nga guroret” per linjen e thyerjes se gurit.

Sipas modelit të lëshuar nga MPPT/MTI/MEI apo Ministria kompetente e linjes.Shoqëritë e huaja duhet te kene kryer ekuivalentimin (njehsimin) e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Transportit dhe Infrastruktures, Republika e Shqipërisë, sic percaktohet ne Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, e miratuar me VKM Nr.42, date 16.01.2008

- Per linjat e mesiperme, Operatori Ekonomik ofertues duhet qe te kete ne stafin e tij mbeshtetes minimalisht 1 (një) Inxhinier Mekanik i specializuar per Impiantet. Per kete operatori ekonomik duhet te dorezoje Kontrate noteriale pune, Liçencen per Inxhinierin si dhe te jete ne listepagese.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës bazuar ne VKM nr. 629, datë 15.7.2015, “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018), specifikimet teknike te projektit, volumet e miratuara nga projektuesi.

Shënim: Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit deshmues për kërkesat që përshihen në formularin përmbledhës të vetedeklarimit, mbajme në konsideratë përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM 285, DT.19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet që “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorezimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjar “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j”, të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqeruese të ofertes, të dorezuara në rrugë elektronike. Keto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

11. Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë dhe të paraqesë këto certifikatat e vlefshme si më poshtë:

a) Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë **ISO 9001:2015** (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë çertifikatën e mesiperme.

b) Çertifikatën mbi sitemet e menaxhimit të ambientit **ISO 14001-2015** (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë çertifikatën e mesiperme.

c) Çertifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në punë **SSH 45001-2018**, (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë çertifikatën e mesiperme.

d) Çertifikatën mbi sistemet e menaxhimit të integruar **Pas 99:2012** (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë çertifikatën e mesiperme.

e) Çertifikatën mbi sitemet e menaxhimit të përgjegjshmerisë sociale **SA 8000-2014** (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rast të bashkimit të Operatoreve Ekonomik (JV) ky kriter mund të plotësohet nga i gjithë bashkimi i operatoreve.

f) Çertifikatën mbi sitemet e menaxhimit të energjisë për kompaninë **ISO 50001-2018** (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rast të bashkimit të Operatoreve Ekonomik (JV) ky kriter mund të plotësohet nga i gjithë bashkimi i operatoreve.

g) Çertifikatën mbi sistemin e menaxhimit të sigurisë në trafikun rrugor **ISO 39001:2012** (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë çertifikatën e mesiperme.

Certifikatat e mesiperme duhet të jetë e vlefshme dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga RSH”.

Argumentimi: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 10 gërma “a”- “e” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: *“Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”*, si dhe ne zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”*. ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërmarrje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërmarrjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

Certifikatën **OHSAS 18001** ISO 45001-2018 është standard ndërkombëtar, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushjen me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

Pas 99:2012 Sistemi i Menaxhimit të Integruar, ISO udhëzues 72 (një standard për shkrimin e standardeve të sistemit të menaxhimit të) i bazuar në gjashtë kushtet e përgjithshme, është një specifikim i integruar i parë kërkesat e sistemit të menaxhimit të botës.

Ky standard ju mundëson për të shfaqur veprimet tuaja aktivitetet dhe procedurat më efektive janë zhvilluar në përgjigje të kërkesave të tregut drejt shkrirjes në një strukturë të vetme.

Sistemi i Menaxhimit të Integruar më shumë se një sistem i menaxhimit, i cili është i gjithë sistemi i institucioneve të formuara duke sjellë së bashku. Sisteme të sigurojë fitim në shumë mënyra zgjidhjen e problemeve afruar në një holistik në vend se zgjidhjen e këtyre strukturave veç e veç.

Certifikimit Menaxhimi i Integruar i tregon se ju të përmbushë të gjitha përgjegjësitë tuaja dhe klientët potencial, furnizuesit, investitorët dhe aksionarët të përforcojë besimin në organizatën tuaj.

SA 8000-2014 Certifikimi SA8000 është një standard i sistemeve të menaxhimit, i modeluar sipas standardeve ISO. Kriteret kërkojnë që objektet që kërkojnë të fitojnë dhe mbajnë certifikim duhet të shkojnë përtej përputhshmërisë së thjeshtë me standardin. Objektet e ardhshme duhet ta integrojnë atë në praktikën e tyre të menaxhimit dhe të demonstrojnë pajtueshmëri të vazhdueshme me standardin. SA8000 bazohet në parimet e normave ndërkombëtare të të drejtave të njeriut siç përshkruhen në konventat e Organizatës Ndërkombëtare të Punës, Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve dhe Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut. Ai mat performancën e kompanive në tërë fushën e rëndësishme për llogaridhënien sociale në vendin e punës: puna e fëmijëve, puna e detyruar, shëndeti dhe siguria, shoqërimi i lirë dhe negociatat kolektive, diskriminimi, praktikën disiplinore, orari i punës dhe kompensimi.

ISO 50001-2018 Objektivi kryesor i standardit është të përmirësojë vazhdimisht performancën e lidhur me energjinë dhe efikasitetin e energjisë dhe të identifikojë mundësitë e reduktimit të energjisë. Kjo qasje sistematike do t'i ndihmojë organizatat të krijojnë sisteme dhe procese. Menaxhimi i qëndrueshëm i energjisë i ndihmon organizatat të kuptojnë potencialin e pashfrytëzuar të efikasitetit të energjisë. Ata do të përfitojnë nga kursimet e kostos dhe do të japin një kontribut të rëndësishëm në mbrojtjen e mjedisit dhe klimës, për shembull nga reduktimi i përhershëm i emetimeve të CO₂. [4] Standardi duhet të paralajmërojë punonjësit dhe në veçanti nivelin e menaxhimit për përfitimet e menjëhershme dhe afatgjata të menaxhimit të energjisë që mund të arrihet. Organizata mund të zbulojë kurse të mundshme dhe avantazhe konkurruese. Për më tepër, mund të krijohet një rritje e madhe e imazhit për organizatën.

ISO 39001:2012 Sistemet e menaxhimit të sigurisë së trafikut rrugor (RTS) - Kërkesat me udhëzim për përdorim është një standard ISO për një sistem menaxhimi (i ngjashëm me ISO 9000) për sigurinë e trafikut rrugor. Zbatimi i standardit synon t'u mundësojë organizatave të përmirësojnë sigurinë e tyre në trafik dhe të zvogëlojnë numrin e personave të vrarë ose të plagosur rëndë.

12. Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë :

Cdo ofertues do të paraqesë **Plan Organizimin e Punimeve** në objekt të shoqëruar dhe me një relacion shpjegues, ku të reflektojë të gjitha masat tekniko-organizative dhe elementet e tjera që kërkon një plan organizimi.

Cdo ofertues do të paraqesë edhe **Grafikun i Punimeve** në përputhje me afatin e realizimit të punimeve të kërkuar.

Argumentimi: Në bazë Ligjit 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” ndryshuar dhe VKM nr.2 dt.13.05.2005 Për zbatimin e punimeve të ndërtimit janë pjesë e Projektorganizimit me anë të të cilit Sipërmarrësi i punimeve programon kryerjen e punimeve, dhe vkm nr 285/2020, neni 39, pika 3.

13.Cdo ofertues do të paraqese **Planin e Sigurise ne Kantier** per punimet ne objekt ne format sipas VKM nr.692 date 13.12.2001 "Per masat e vecanta te sigurimit dhe ruajtjes se shendetit ne pune, te ndryshuar me VKM nr.742 date 06.11.2003.Nje pershkrim i detajuar te planit te Zbatimit te Kerkesave per Sigurimin Teknik dhe Shendetit ne Pune (Health, Safety and Environment HSE) ne perputhje me planin e Menaxhimit te Sigurimit Teknik dhe Shendetit ne Pune.

Argumentimi:Në zbatim të VKM nr.692 date 13.12.2001 "Per masat e vecanta te sigurimit dhe ruajtjes se shendetit ne pune, te ndryshuar me VKM nr.742 date 06.11.2003.Nje pershkrim i detajuar te planit te Zbatimit te Kerkesave per Sigurimin Teknik dhe Shendetit ne Pune (Health, Safety and Environment HSE) ne perputhje me planin e Menaxhimit te Sigurimit Teknik dhe Shendetit ne Pune, ligjit nr 162/2020, neni 77.dhe VKM nr.2 dt.13.05.2005 Për zbatimin e punimeve të ndërtimit

14.Vetëdeklarim nga operatori ekonomik që brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor /nënkontraktor për kontratë / kontrata të lidhura, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, jo më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon kandidati, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent. Në kuptim të përcaktimit të mësipërm, fjala “*periudhë*” nënkupton kohëzgjatjen e investimit të kryer sipas LPP-së nga çasti i shpalljes fitues e deri në kolaudimin e objektit / investimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”si dhe nenit *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST, dhe mbështetur në Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.*

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.